

SHQIPËRI-KOSOVË, PROJEKTET E PËRBASHKËTA

Në mbledhjen e përbashkët të disa ministrave të Qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës, ministrja Balluku dhe homologu kosovar diskutuan mbi ecurinë dhe vendosmërinë për hapjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës në pikën kufitare Morinë - Vërmicë, zbatimin e marrëveshjes për uljen e tarifave Roaming dhe ecurinë e zbatimit të vendimit për njohjen reciproke të patentave.

NDËRTIMI I RRJETIT 20 KV NË GJIRIN E LALËZIT

Pas ndërtimit të nënstacionit elektrik, në zonën e Gjirit të Lalëzit po vijon puna për ndërtimin e rrjetit 20 kilovolt. Punimet kanë me nisur ndërtimin e 3 fiderave të parë nga 8 gjithsej. Nga ky nënstacion do furnizohen me energji plazhi i Gjiri i Lalëzit, Manza, Ishmi e deri te Kepi i Rodonit. Investimi parashikon shtrimin e rrjetit të tensionit të ulët dhe të mesëm si dhe ndërtimin e 155 kabinave.

“FORUMI NDËRKOMBËTAR I TRANSPORTIT”

Ministrja Balluku mori pjesë në Ministerialin “Forumi Ndërkombëtar i Transportit” që u mbajt në Lejpcig të Gjermanisë. Konektiviteti global si dhe kuotat multilaterale për transportin rrugor të mjeteve transportuese të tonazhit të lartë ishin në fokus të këtij ministeriali. Heqja e kufizimeve mbi sasinë e licencave duke krijuar një treg të përbashkët të hapur ishte kërkesa e adresuar nga disa prej vendeve anëtare të ITF-së.

BYPASS I VLORËS GATI BRENDA AFATEVE

Bypass-i i Vlorës, një ndër veprat më të rëndësishme infrastrukturore në jug të vendit, do të jetë gati brenda afateve të parashikuara në kontratë. Aktualisht kanë përfunduar gati 12% e punimeve dhe e gjithë vepra do të jetë gati në fillim të vitit 2021. Krahas përfundimit në kohë të punimeve po merren masa që ato të mos ndikojnë në mjedis.

RIPARIMI I AKSIT ELBASAN-PEQIN

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka nisur punën për riparimin e shtresave asfaltike të dëmtuara përgjatë segmentit rrugor Elbasan - Peqin. Kjo ndërhyrje do të bëjë të mundur rritjen e nivelit të sigurisë rrugore për përdoruesit e shumtë të këtij segmenti si dhe do t’u garantojë komoditet në lëvizje qytetarëve në prag të sezonit turistik.

UJËSJELLËS I RI NË KËLCYRË

AKUM do të nisë investimin për ujësjellësin e ri të Bashkisë Këlcyrë. Në saj të këtij investimi, afro 6500 banorë të kësaj zone do të kenë 24 orë furnizim me ujë të pijshëm. Prej më shumë se 30 vitesh banorët e Këlcyrës kanë vuajtur aksesin në ujë të pijshëm edhe pse zonë me burime ujore të pasura. Investimet e fundit në sektorin e ujësjellësit në këtë zonë datojnë në vitin 1980.